



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.Sh.Sh.II.nr.723/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Faton Bajrami, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP PBC Kosova me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim Blerim Sylja avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.227/22 të datës 21.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.06.2024, merr:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit NTP PBC Kosova me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.227/22 i datës 21.02.2024, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar, ka vendosur si në vijim: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NTP PBC Kosova, Anulohet si i kundërligjshëm vendimi PSH.nr.131/2014 dt.26.10.2018 i nxjerr nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, në Prishtinë, II. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit NTP PBC Kosova, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi NTP PBC Kosova, është operator ekonomik i përgjegjshëm në procedurën e prokurimit MF-201-013-049-214 i inicuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Financave me titull “Integrimi i sistemeve softuerike dhe implementimi i sistemit raportues”, III. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit NTP PBC Kosova, me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, në Prishtinë, ti kompensoj dëmin

material i shkaktuar në formën e fitimit të humbur në shumën prej 693,730.88€ dhe në formën e dëmit real shumën prej 7,967.36€ të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga paraqitja e padis dt.30.01.2019 e deri në përmbushjen përfundimtare, IV. Ky aktgjykim zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter detyrues, V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar ka ushtruar ankesë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të Aprovohet ankesa e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar, dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, shqyrtoi ankesën e paditurës, aktgjykimin e ankimuar, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se organi i paditur Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, ne rivendosje, me vendimin përfundimtar P.SH.nr.131/2014 datës 26.12.2018, ka bërë zbatimin e vendimit të Gjykaës Themelore-Deparamenti për çështje administrative në Prishtinë, A.nr.1083/14 dt.11.10.2018, dhe ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Integrim i sistemeve dhe implementimi i sistemit raportues” me nr.prokurimit 201/013/049/2014 të inicuar nga autoriteti kontraktues-Ministria e Financave.

I pakënaqur me vendimin e të paditurës, paditësi me padi inicon konflikt administrativ në Gjykatën e shkallës së parë, e cila në këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor me datë 06.02.2024, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, merr Aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e Aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit NTP PBC Kosova me seli në Prishtinë, duke vendosur si n dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetim ndër të tjera gjykata e shkallës së parë ka theksuar se paditësi kishte qenë operator ekonomik i përgjegjshëm, pasi që nga ekspertiza e lëmis së prokurimit publik, u vërtetua se paditësi kishte qenë i përgjegjshëm dhe AK Ministria e Financave kishte zbatuar drejt dispozitat ligjore me rastin e zhvillimit të aktivitetit të prokurimit me titull “Integrim i

sistemeve dhe implementimi i sistemit raportues” me nr.prokurimit 201/013/049/2014, dhe se i padituri OSHP nuk kishte vepruar drejt me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit. I padituri me rastin e nxjerrjes së vendimit kontestues, nuk ka arritur që të ndërtoj strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 të LPPA, pasi dispozitivi i vendimit të kontestuar është në kundërshtim me arsyetimin dhe gjendjen faktike të ëprshkruar në arsyetim. Në arsyetim të vendimit nuk mund të kuptohet se për cilën pjesë i padituri aprovon ankesën dhe për cilën pjesë refuzon ankesën, për më tepër nuk adreson të metat e konstatuara me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, prandaj vendimi i te paditrit PSH.nr.131/2014 dates 26.10.2018 duhet të anulohet pasi që nuk është nxjerr në përputhje me dispozitat e LPP-së. Gjykata refuzoi si të pabazuar kerkespadin e paditësit me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se është i përgjegjshëm në procedurën e prokurimit, pasi që gjykata vlerëson se i takon vetëm AK, që të realizoj një aktivitet të prokurimit ndërsa në rast të refuzimit të vazhdimit përkatësisht realizimit të aktivitetit të prokurimit në mënyrë të kundërligjshme, AK është përgjegjës për shpërblimin e dëmit lidhur me shpenzimet që operatori ekonomik mund të ketë gjatë fazës së aplikimit. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimin, gjykata vendosi duke u mbështetur në nenin 119 par.3 të LPP-së., pasi që nga kjo dispozit ligjore, gjykata mund të obligoj vetëm autoritetin kontraktues kompensimin e dëmit ndj operatorit ekonomik ndërsa OSHP nuk ka legjitimitet real pasiv për kompensimin e dëmit ndaj operatorve ekonomik.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, në bazë të ankesës së paditësit dhe sipas detyrës zyrtare të njëjtin e konfirmon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar në prova dhe ligj.

Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar administrativ në bazë të padisë, përgjigjes në padi provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesorë si dhe shkresave të tjera të lëndës si në vështrim të nenit 44 të LKA, dhe drejtë e ka vendosur çështjen me aprovimin e kërkesë padisë së paditësit.

Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se vendimi i atakuar i të paditues OSHP-së, përmban të meta të cilat konsistojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të nenit 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe në dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik,

nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike lidhur me pretendimet ankimore gjatë procedimit administrativ ne rivendosje nga e paditura, nuk janë marrë për bazë vërejtjet Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje administrative, me aktgjykimin A.nr.1083/14 dt.11.10.2018, me qka konstatohet se e paditura ka nxjerr vendimin kontestues, në mënyrë të kundërligjshme. Përkundrejt fakteve të vërtetuara në konflikt administrativ përmes ekspertizës së prokurimit dt.05.09.2023 se paditësi kishte qenë i përgjegjshëm lidhur me aktivitetin e prokurimit të inicuar nga autoriteti kontraktues-Ministria e Financave, dhe në anën tjetër faktit se autoriteti kontraktues ka anuluar aktivitetin ekonomik duke zbatuar vendimin e paditurit OSHP-së, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë vleron se gjykata e shkallës së parë me të drejt ka aprovuar pjesërisht kërkespadin e paditësit duke vendosur si ne dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në raport me pretendimet e paditësit në ankesë, se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike si në pikën II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit ankimor, duke e refuzuar si të pabazuar kërkesën që tani paditësi në këtë procedurë të prokurimit të shpallet operator ekonomik i përgjegjshëm dhe duke refuzuar kërkesën për kompensimin e dëmit material, këto pretendime ankimore, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i refuzoi si të pabazuara, për faktin se duke u bazuar gjithnjë në provat e administruara në konflikt administrativ, dhe precizimit të kërkespadis së paditësit me parashtesen e datës 26.01.2024, pranë gjykatës së shkallës së parë, duke kërkuar që e paditura OSHP-ja, në emër të dëmit të pësuar real dhe fitimit të humbur, t,ia paguaj paditësit kompensimin sipas vlerave të precizuara, Kolegji vleron se në rastin konkret gjen zbatim dispozita e nenit 119 paragrafi 3 i Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, në të cilën është referuar edhe gjykata e shkallës së parë. Paditësi me precizimin e kërkeses kërkon nga gjykata që ta detyroj të paditurin OSHP-së, si organ administrativ i shkallës së dytë, që t,ia kompensoj dëmin material, ndërsa në rastin konkret dispozita ligjore e lartcekur kërkon që gjykata mund ta obligoj vetëm autoritetin kontraktues në kompensimin e dëmit ndaj operatorit ekonomik. Prandaj edhe Kolegji nuk gjen bazë ligjore që të aprovoj pretendimet ankimore të paditësit, ashtu që ta detyroj në këtë rast të paditurin OSHP, për shkak të nxjerrjes së vendimit të kundërligjshëm, në komopënsimit e dëmit ndaj operatorit ekonomik në këtë rast paditësit.

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk kemi vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, apo aplikim të gabuar të drejtës materiale, dhe se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejt, i ligjshëm dhe i mbështetur në prova dhe fakte, pasi që gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar vendimin e saj duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të palës ankuese në ankesë mirëpo, të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk kishin ndonjë ndikim në vendosje ndryshe, andaj edhe vendosi që aktgjykimin e shkallë së parë ta vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA-së, dhe neni 12 të Ligjit 08/L-015, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.723/2024 me datë 18.06.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari

Krenar Berisha